

SISTEMI NDËRBANKAR I PAGESAVE



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



SISTEMI NDËRBANKAR I PAGESAVE (SNP)

SNP është një platformë e cila plotësisht bazohet në teknologjitë më të avancuara, ISO 20022 standarde dhe është i dëshmuar të jetë një sistem i qëndrueshëm dhe stabil, i cili i ka plotësuar me përpikëri nevojat e komunitetit bankar dhe përdoruesve të tij.

SNP është sistem i automatizuar për procesimin e transaksioneve të pagesave ndër-bankare (ATS) në Republikën e Kosovës.

Ky sistem i pagesave kryen kliringun e të gjitha pagesave me vlera të mëdha dhe të vogla, duke përfshirë: pagesat prioritare, individuale, në grup/ masive, Kos-Giro, Debitim Direkt, Letrat me Vlerë, etj.



Sistemi i Transferit Automatik

ATS (Automatic Transfer System/Sistemi i Transferit Automatik) përbëhet nga dy komponentë kryesor: komponenti i RTGS-së (Real Time Gross Settlement/shlyerjet bruto në kohë reale) i cili mundëson transferimin e fondeve në kohë reale, si dhe komponenti ACH (Automatic Clearing House/sistem automatik i kliringut) që bënë procesimin e pagesave në grup dhe me vlerë të vogël, në tri sesione të kliringut ndërbankar në BQK.



Roli i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është pronare dhe operatore e sistemit të vetëm të pagesave në Kosovë, Sistemi i Pagesave Ndërbankare (SPN).

Sistemi i Pagesave Ndërbankare vepron i organizuar dhe i mbikëqyrur nga BQK-ja, e cila përveç si administruese dhe rregullatore e këtij sistemi, po ashtu merr pjesë direkt në këtë sistem në emër të saj dhe institucioneve të qeverisë.

Prandaj, objektivi parësor i Bankës Qendrore është të nxisë dhe të mbajë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave dhe një infrastrukturë stabile.




Pjesëmarrësit në SPN

Aktualisht janë katërbëdhjetë (14) pjesëmarrës direkt në SPN. Kjo përfshinë njëmbëdhjetë (11) banka komerciale dhe BQK-në (në emër të vet dhe të Qeverisë), MF/Thesari (për tri institucione)FKPK, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, dhe Operatorë të sistemeve të pagesave të licencuar nga BQK.

Të gjitha bankat e licencuara në Kosovë marrin pjesë në SPN.

Institucionet mikro-financiare, kompanitë e sigurimeve, etj. mbajnë llogari bankare tek pjesëmarrësit direkt (bankat) , të cilët veprojnë si agentë të tyre të pagesave.



Pagesat prioritare

Pagesat prioritare mund të inician në çdo kohë gjatë ditëve të punës të SPN-së dhe të cilat duhet të klirohen menjëherë nga SPN në baza bruto. Pagesat individuale janë transfere krediti të cilat zakonisht inician në një degë të bankës nga paguesi përmes një urdhërpagese në formë letër dhe formë elektronike.




Pagesat Kos-Giro

Pagesat Kos-Giro janë një mënyrë më efikase me të cilën konsumatorët mund të paguajnë faturat. Sipas skemës, faturuesit si psh. kompanitë e shërbimeve publike, institucionet qeveritare si shërbimi doganor dhe Agjensioni Kosovar i Pronave, etj. përfshijnë një formular të standardizuar të pagesave në fund të çdo fature që iu dërgojnë konsumatorëve të tyre. Këto fatura të standardizuara përmbajnë në vete të dhëna mbi pagesën në barkodin e shtypur, i cili skanohet lehtësisht nga barkod lexuesi i bankave. Pas skenimit të faturës, pagesa procesohet automatikisht nga ana e bankës. Së pari futet në sistemin qendror të bankës komerciale dhe më pas procesohen në SPN për kliring.



Debitimi Direkt

Debitimi Direkt është lansuar për përdorim nga publiku në Nëntor 2009. Ky është një instrument pagese me të cilin klienti autorizon bankën e vet përmes kompanisë të debitorit (tërheqë) mjete direkt nga llogaria bankare. Ky instrument paraqet një mënyrë të standardizuar dhe të automatizuar që është e përshtatshme për pagesa të rregullta dhe të përsëritura.





BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Adresa: Rr. Garibaldi nr. 33,

Prishtinë, Kosovë

www.bqk-kos.org

E-mail: info@bqk-kos.org

Telefon: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763